




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr 03/L-040 (Gazeta zyrtare nr 28/2008), nenit 19 të Regullorës nr.02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në Organizata Buxhetore dhe Udhëzimit Administrativ nr.21/2009 për Menaxhimin e Pasurisë Qeveritare, Kryetari i Komunës së Vitisë, bien këtë:

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR INVENTARIZIMIN E PASURISË SË KOMUNËS MBI 1000,00€ PËR ADMINISTRATËN KOMUNALE

Neni 1

Për inventarizimin e pasurive të Komunës formoj Komisionin në këtë përbërje

1. Arian Alidema - Kryetar i Komisionit
2. Rexhep Osmani - Anëtar i Komisionit
3. Ismet Sejdiu - Anëtar i Komisionit

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit.

Komisioni në pajtim me Rregulloren e MF. nr 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Qeveritare, Organizata Buxhetore ka për detyrë dhe përgjegjësi si vijon:

1. Inventarizimin e të gjithë pasurisë jo financiare që është në pronësi dhe në kontroll të Komunës,
2. Verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së pasurisë jo financiare,
3. Krahasimin e gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare,
4. Identifikimin e pasurisë që nuk ka vlerë të bartur,
5. Identifikimin e pasurive të dëmtuara dhe jashtë përdorimit,
6. Përgatitjen e raportit për kryerjen e inventarizimit,
7. Hartimin e raportit të përgjithshëm në bazë të raporteve individuale të Komisionit për Inventarizimin e Pasurisë jo Financiare jo më larg se 10 janar 2022.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Vitisë.

Viti: 23.11.2021.

Vendimi u dorëzohet:

1. Anëtarëve të Komisionit
2. Zyrës së Kryetarit
3. Drejtorisë për Financa
4. Arkivit

KRYETARI I KOMUNËS
Sokol Haliti

